



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:052226

Datë: 19.03.2024

Numri i dokumentit: 05472563

KPPP.nr. 1002/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbartimore të kreditorit TEB Sh.A., me seli në Prishtinë, Preoc, p.nr., Graçanicë, km 7, Magjistranja Prishtinë - Ferizaj, kundër debitorëve; 1. Lenti 1 DPT , me numër të biznesit 71141160 dhe seli në Mitrovicë, Kqiq i Madh; 2. S.I. me adresë në Vushtrri, rr. "Shala"; 3. Kombi Taxi S.B., me numër të biznesit 80334567 dhe seli në Mitrovicë, Kqiq i Madh; 4. E.B. me adresë në Ferizaj, rr. "Naim Bega"; 5. M.M. me adresë në Vushtrri, fshati Maxhunaj, duke vendosur sipas prapësimit të debitorit E.B., të ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 05/23 të lejuar me datë 23.01.2023 nga Përmbartuesi Privat Atip Mustafa, me seli në Mitrovicë, jashtë seancës, me datë 19.03.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit E.B. nga Ferizaj, ashtu që Urdhri Përmbartimor P.nr. 05/23 i lejuar me datë 23.01.2023 nga Përmbartuesi Privat Atip Mustafa, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit TEB Sh.A., me datë 23.01.2023 ka lejuar Urdhrit Përmbartimor P.nr. 05/23, duke detyruar debitorët 1. Lenti 1 DPT , 2. S.I.; 3. Kombi Taxi S.B., 4. E.B. dhe 5. M.M. që mbi bazën e dokumentit përmbartimor Marrëveshje mbi pengun Nr. 64848, e datës 27.12.2017, e regjistruar në regjistrin e pengut sipas Konfirmimit mbi regjistrimit e pengut me R-20171229-172, për sigurimin e kërkesave nga Shtojca nr. 2 e Marrëveshjes mbi kredinë nr. 64848, e datës 27.12.2017, si dhe Kontratës mbi Hipotekën LRP.nr. 13573/2018, e datës 12.11.2018, e regjistruar sipas Aktvendimit mbi regjistrimin e hipotekës nr. 200-55453/2018, të datës 15.11.2018, t'ia paguajnë kreditorit borxhin në vlerë prej

8,318.25 EUR (me shkronja: tetë mijë e treqind e tetëmbëdhjetë euro e njëzet e pesë euro cent) me kamatë vonesë e arritur deri më tani, si dhe kamatat që do të llogariten deri në përfundim të procedurës.

Debitori E.B., brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor, me arsyetimin se urdhri përmbarimor është lejuar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së dhe se nuk i janë dorëzuar provat e propozuara në propozimin për përmbarim. Ka shtuar se nuk qëndron obligimi i debitorit për pagesën e shumës së kërkuar sepse i njëjti nuk ka nënshkruar asnjëherë marrëveshje pengu apo të ketë qenë ndonjëherë garantues. Tutje, ka shtuar se automjeti i specifikuar në listën e pengut Nr. 64848, i datës 04.12.2017 i'a ka shitur blerësit (bashkë-kredimarrësit) S.I. dhe të njëjtin nuk e ka në posedim e as në pronësi prej më shumë se 5 vitesh. I ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhrin përmbarimor ta anulojë.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka kundërshtuar prapësimin e debitorit me arsyetimin se i njëjti është i pa bazuar dhe ka për qëllim vetëm zvarritjen e procedurës përmbarimore, duke qenë se nuk është bazuar në asnjëherë prej shkaqeve të parapara për paraqitjen e prapësimit sipas nenit 71 të LPP-së. Tutje, ka shtuar se sa i përket pretendimeve të debitorit se nuk i janë dorëzuar provat, një pretendim i tillë nuk qëndron sepse vet fakti i paraqitjes së prapësimit tregon që i njëjti ka qenë i njoftuar për procedurën e filluar dhe në bazë të atyre dokumenteve e ka paraqitur prapësimin. Sa i përket pretendimit të debitorit se nuk ka nënshkruar kontratën e kredisë, çështja e nënshkrimit është një çështje që i përket organeve të tjera, pasi që kjo është procedurë e përmbarimit, mirëpo në kontratë figuron nënshkrimi i debitorit, ku kredia ka qenë e siguruar me veturën e debitorit. I ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbarimor të vërtetohet.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes së kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi për arsyet si në vijim:

Sipas nenit 21 të LPP-së përcaktohet se: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*, ndërsa sipas nenit 22, pika

1.7 përcaktohet se “kontrata për hipotekën e vërtetuar nga organi kompetent dhe regjistruar në regjistrin publik sipas ligjit”, ndërsa, me nenin 5, paragrafi 2 të Ligjit 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore përcaktohet se dokument përmbartues paraqet: “...kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut...”. Në anën tjetër, me nenin 27 par.1 të LPP-së përcaktohet se “Dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbartjes së detyrimit”.

Gjykata duke vlerësuar Marrëveshjes mbi pengun Nr. 64848 e datës 27.12.2017, si dhe Kontratën mbi hipotekën LRP.nr. 13573/2018 e datës 12.11.2018, gjeti se të njëjtat janë hartuar në formën e paraparë me ligj dhe janë regjistruar në regjistrat publik, fakt ky që vërtetohet nga Konfirmimi mbi regjistrimit e pengut me R-20171229-172, respektivisht Aktvendimi mbi regjistrimin e hipotekës nr. 200-55453/2018 të datës 15.11.2018, e po ashtu i janë bashkangjitur propozimit për përmbartim në origjinal, dhe si të tilla përbëjnë bazë juridike për caktimin e përmbartimit, ngase i kanë plotësuar kushtet ligjore nga neni 22, pika 1.7 dhe 1.7a, lidhur me nenin 27 të LPP-së, për të qenë dokumentet të përmbartueshme dhe njëkohësisht të përshtatshme për përmbartim.

Në anën tjetër, gjykata gjeti se debitori E.B., në cilësi të garantuesit, përmes marrëveshjes mbi pengun nr. 64848 e datës 27.12.2017 ka garantuar me automjetin e tij personal me numër identifikues ..., dhe i cili automjet është pjesë e listës së sendeve të regjistruara si peng pranë regjistrin publik të pengut sipas konfirmimit mbi regjistrimit e pengut me R-20171229-172, andaj përmbartimi në raport me debitorin E.B. shtrihet vetëm sa i përket sendeve të cilat i njëjti ka lënë peng.

Gjykata ka vlerësuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim se i njëjti me rastin e pranimit të shkresave të lëndës, nuk është pajisur me dokumentin përmbartimor, por që nga flete dërgesa për dorëzim personal e Përmbartuesit Privat, rezulton se debitorit i është dorëzuar propozimi për përmbartim së bashku me marrëveshjen mbi pengun e në anën tjetër, nga vet pretendimet e debitorit në prapësim, rezulton se nuk është kontestues fakti se i njëjti është pajisur me rregull me shkresat e lëndës, pasi që në prapësi, i njëjti i referohet listës së sendeve të lëna peng, listë kjo që është pjesë e marrëveshjes së pengut.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera të debitorit mirëpo gjeti se të njëjtat nuk paraqesin bazë për anulimin e urdhrin përmbartimor në kuptim të nenit 71 të LPP-së, ndërsa në mbështetje të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga sa më sipër, në mbështetje të nenit 73, paragrafi 1 dhe 3 të LPP-së, si dhe nenit 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1002/23, datë 19.03.2024

Gjyqtari
Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimin të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.